



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: rmuca@klsb.org.al; Web-site: www.klsb.org.al

Nr. 1107/26 Prot.

Tiranë, më 23/09/2016

V E N D I M *Nr.118, Datë 23/09/2016*

PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS "Shkollimi Profesional në Shqipëri"

Në zbatim të planit vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas programit të auditimit nr. 1107/4, datë 09.03.2016 realizoi auditimin e performancës me temë **"Shkollimi Profesional në Shqipëri"**. Ky auditim u programua për t'u ushtruar në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit dhe Formimit Profesional, Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Qendrat e Formimit Profesional dhe Shkollat e Mesme publike të arsimit profesional të shpërndara në 12 qarqet; Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë. Pas përfundimit të punës paraprake audituese u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr. 1107/30, datë 17.07.2016 u dërgua projekt-raporti i auditimit në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me detyrimin e shpërndarjes në të gjitha institucionet e sipërcituara. Raporti i auditimit është hartuar pasi janë shqyrtuar dhe u morën parasysh të dhënat sipas pyetësorëve dhe shpjegimeve të dërguara nga institucionet e përfshira në këtë auditim të cilat janë trajtuar në mënyrë të hollësishme në Raport Auditimin.

Në përfundim, pasi u njoha me Raportin e Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga institucionet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10, 13, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" :

KONKLUDOVA:

Në politikat shoqërore të një vendi, vend të rëndësishëm zë mbrojtja edhe ngritja e një sistemi sa më cilësor të arsimit dhe formimit profesional.

Çdo gjë të mirë, e mësova nga librat.

Abraham Lincoln

Kalimi nga një ekonomi e kontrolluar në një ekonomi të decentralizuar, e orientuar tërësisht drejt sektorit privat, solli ndryshime drastike në funksionimin e tregut të punës dhe sistemit arsimor në përgjithësi dhe atij profesional në veçanti, në përshtatje me realitetin e ekonomisë së tregut të lirë, çka ka çuar dhe në ristrukturimin e politikave të arsimit, kualifikimit dhe punësimit në tregun e punës.

Një rol të rëndësishëm kanë politikat që realizohen në përfshirjen e arsimit, formimit dhe kualifikimit profesional në harmoni të plotë dhe në përshtatje me kërkesat e tregu të punës. Shkalla arsimore dhe kualifikimi profesional ndikon në tregun e punës e janë tregues cilësorë të nivelit të dijeve dhe aftësive që duhen për përgatitjen e specialisteve përherë e më të kualifikuar për çdo sektor të veprimtarisë shoqërore, kusht i domosdoshëm për zhvillimin e teknologjisë, kulturës dhe artit, për rritjen e mirëqenies, duke bërë të mundur zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së vendit, për sot dhe për brezat e ardhshëm.

Roli i arsimit dhe formimit profesional është një nevojë për të gjitha vendet të cilat synojnë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, kulturor dhe social, arsimi gjatë gjithë jetës është vendimtar në ndërtimin e një shoqërie të tillë. Arsimi dhe aftësimi profesional pajis nxënësit me njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime që iu mundësojnë atyre t'i plotësojnë nevojat e të sotmes dhe sfidat e së nesërme.

Arsimi Profesional dhe Formimi Profesional kanë një zhvillim të ulët nga pikëpamja cilësore, si dhe në to angazhohen një përqindje e ulët e të rinjve apo të rriturve, megjithëse këto vitet e fundit ka patur një rritje sasiore për shkak të disa politikave stimuluese të qeverisë që kërkojnë domosdoshmërisht të ushtrojnë një “presion” pozitiv në nivelet politike për të kaluar nga “riparimet e pjesshme sipas nevojave të çastit” drejt “zgjidhjeve të plota e afatgjata” në kontekstin e integritit rajonal dhe europian.

Ndërmjet këtij auditimi performance jemi mundur të ndihmojmë të skicojmë dhe adresojmë rrugën për përmbushjen dhe plotësimin e përparësive strategjike gjithëpërfshirëse të arsimit dhe formimit profesional kaq të rëndësishëm për sigurimin e punonjësve të kualifikuar, të nevojshëm për tregun e punës, gjithashtu, kërkojmë të promovojmë bashkëveprimin ndërmjet, qeverisjes qendrore, pushtetit vendor, shoqërisë civile, grupeve të interesuara, komunitetit të biznesit dhe publikut të gjerë, se rritja e performancës së arsimit dhe formimit profesional, është investimi që ndikon në zhvillimin tërësor të tregut të punës dhe ekonomisë së vendit.

Auditimi i performancës synon të promovojë **përmirësime në performancën e shërbimeve publike**. Filozofia e re drejtuese në KLSH e ka vënë auditimin e performancës në qendër të vëmendjes si motor të zhvillimit institucional, i cili synon të promovojë **përmirësime në performancën e shërbimeve publike**. Misioni i KLSH-së në Planin

Strategjik 2013-2017 përkufizohet; **Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomicitet, efizienz dhe efektivitet nga pushteti qendror dhe lokal dhe nga njësi të tjera publike**, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me direktivat e praktikave me të mira të BE-së dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, duke kontribuar për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.



Udhëzimet e reja të auditimit të performancës (Udhëzuesi, Manuali dhe Indikatorët) të mbështetura në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI 3000 & 3100), nxisin një orientim drejt nevojave të qytetarëve. **“Auditimi i performancës”** ka të bëjë me auditimin e ekonomicitetit, efizienz dhe efektivitetit dhe përfshin:

- a) auditimin e *ekonomicitetit*, që nënkupton minimizimin e kostos së burimeve që përdoren në një veprimtari publike, duke mos cenuar cilësinë e tij.
- b) auditimin e *efizienzës*, që nënkupton optimizimin e raportit burime-rezultate të veprimtarisë publike, duke modifikuar proceset, strukturat dhe gjithë zinxhirin ekonomik të vlerës, në përputhje me standardet kombëtare e ndërkombëtare dhe praktikave më të mira.
- c) auditimin e *efektivitetit*, që nënkupton vlerësimin e rezultateve përfundimtare dhe objektivave të vendosura, në përputhje me politikave të subjektit të audituar.

Rëndësia e këtij auditimi ka të bëjë me integrimin e arsimit dhe formimit profesional e përshatur atë me nevojat e reja në procesin e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe të tregut të punës duke bërë vlerësimin e reformave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, mbi performancën e shkollimit profesional në Shqipëri, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm dhe promovuar eksperiencën efikase në zhvillimin e gjithanshëm të tij. Në konkluzione pasqyrohet mendimi më bashkëkohor, nevojat për një arsim më cilësor dhe njëkohësisht trendi i integritetit të Shqipërisë në BE edhe në fushën e arsimit profesional parauniversitar, ku mendimet e dhëna të respektojnë interesin kombëtar.

Arsimi dhe formimi profesional në Shqipëri megjithëse ka marrë vëmendjen e duhur këto vitet e fundit, vazhdon të ndeshet me problematikat, që kanë të bëjnë me;

- përcaktimin e fushës, legjislacionit dhe përgjegjësisë shtetërore në funksion të misionit të tij;
- kompetencat, vendim-marrjen dhe bashkëpunimin midis institucioneve qendrore ndërmjet tyre, ashtu si dhe ndërmjet institucioneve qendrore e lokale që merren me arsimin profesional në Shqipëri;
- marrëdhënie të dobëta e efektive të partneritetit me tregut të punës;
- shkëmbimin e praktikave më të mira që sjellin risi dhe modernizim;
- mungesën e laboratorëve për zhvillimin e praktikave sipas profesioneve;
- mungesën e kurrikulave, vlerësimit dhe certifikimit të tyre sipas standardeve

- evropiane;
- përcaktimin e nevojave për profesione dhe prioriteteve të tyre;
- përcaktimit të nevojave për profesione në funksion të kohës për të cilin nevojitet ky profesion;
- krijimin e hapësirave lehtësuese e favorizuese biznesit për trajnimin nga ana e tij e punonjësve për të cilët ka nevojë;
- përcaktimin e kostove për çdo profesion të ofruar nga arsimit dhe formimi profesional;
- përcaktimin e standardeve të trupës pedagogjike;
- trajnimin e aftësisë profesionale të trupës pedagogjike në mësimdhënie në përfitim të përvojave të reja profesionale, duke ndarë dhe përvojën e tyre;
- mënyrën e vlerësimit dhe certifikimit të nxënësve;
- akreditimin e shkollave dhe programeve;
- etj.

Ky auditim ka synuar të trajtojë një përpjekje e angazhim profesional, për të siguruar mirëkuptimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm, për të garantuar edhe të ndihmojë sistemin e arsimit dhe formimi profesional, për një mësimdhënie dhe mësim nxënie që u siguron nxënësve dhe individëve aftësitë për të cilat ka nevojë në tregun e sotëm të punës dhe në të ardhmen.

Qëllimi i auditimit: është përmirësimi i mirëkuptimit të aktorëve të ndryshëm, për të kontribuar në zhvillimin e sistemit të arsimit dhe formimi profesional dhe identifikimin e nevojave, që t'u sigurojë nxënësve, të rinjve dhe individëve pajisjen e tyre me njohuritë dhe aftësitë më të mira profesionale për të cilat ka nevojë në tregun e sotëm dhe të ardhshëm të punës.

Objektivi i auditimit: është pasqyrimi me realizëm dhe objektivitet i situatës, të ndihmojë të rinjtë dhe individë të ndryshëm në zhvillimin dhe edukimin e tyre në fushën e arsimit, trajnimit dhe formimit profesional, duke formuar një sistem unik, duke analizuar problematikën aktuale dhe instrumentet që strukturat shtetërore kanë në dispozicion për të përmirësuar situatën.

Rëndësia e auditimit: është të bëjë vlerësimin e performancën së sistemit të arsimit e formimit profesional dhe të ndihmojë të rinjtë të bëjnë zgjedhje të zgjuara në formimin e tyre profesional dhe karrierën e tyre.

Mesazhi kryesor i këtij auditimi është: “Nxitje të reformave në ndryshimin e mentalitetit të mosvlerësimit të arsimit dhe formimit profesional, motivimin e të rinjve e individëve për të vlerësuar profesione “të lodhshme, të pashpërblyera, të papëlqyera” dhe plotësimin të kërkesave të tregut të punës me punonjës të mirë-kualifikuar”.

Arsimi dhe formimi profesional, nënkupton arsimin dhe aftësimin, me qëllim pajisjen e rinisë e individëve të moshave të ndryshme me një profesion të caktuar dhe shkathtësi profesionale të punësimit.

Sot sfida për arsimin dhe formimin profesional qëndron në rritjen bashkëpunimit të gjithanshëm të institucioneve qendrore e vendore, sipërmarrjeve e bizneseve, partnerëve të tjerë zhvillimor, publikut, etj., për të kërkuar e përshtatur lidhjen e shkallës arsimore dhe të kualifikimit me nevojat e ekonomisë së tregut në vend dhe përshtatja me nevojat e vendeve të rajonit e më gjerë. Gjithashtu për të ndërtuar një sistem të arsimit dhe formimit profesional, të hapur me zhvillimet e teknologjinë bashkëkohore që të lehtësojë punësimin, punën dhe jetën shoqërore të përfituesve, sot e në të ardhmen duke qenë në përputhje me sistemin e BE.

KLSH e ka ndërmarrë këtë auditim performance dhe dhënien e opinioneve, për përmirësimin, modernizimin e sistemit të arsimit dhe formimit profesional, vlerësimin të rezultateve përfundimtare dhe objektivave të vendosura, në përputhje me politikën e ndërmarrë sepse, ai ende nuk është plotësisht në harmoni me parimet e efektivitetit, pavarësisht zhvillimeve të kohëve të fundit, përpjekjeve dhe iniciativave për ndryshime ligjore, masivizimit të tij, etj., në;

- ✓ hartimin e politikave dhe strategjive për vlerësimin e profesioneve dhe profesionistëve;
- ✓ krijimin e një qasjeje të re në luftë me mentalitetin e gabuar të mosvlerësimin të arsimit dhe formimit profesional dhe motivimin e të rinjve e individëve për të vlerësuar profesione *“të lodhshme, të pashpërblyera, të papëlqyera”* për të cilat ka shumë nevojë tregu i punës, bizneset apo ekonomitë e vogla familjare;
- ✓ arritjen e matjes nëpërmjet një sistemi me qark të mbyllur **“arsim-profesion-punësim”**, mbi plotësimin e kënaqësive të palëve të interesit, *qeverisë, të rinjve e individëve, dhe sipërmarrjeve e biznesit*, në arritjen e qëllimit final rritjen e punësimin, punësimin dhe përmirësimin të jetesës e plotësimin të kërkesave të tregut të punës me punonjës të mirë kualifikuar.

Në mënyrë të detajuar të gjitha mangësitë janë trajtuar hollësisht në Raportin e Auditimit rast pas rasti, si gjetje konkrete me konkluzionet përkatëse.

Disa nga mangësitë e konstatuara gjatë këtij auditimi janë;

- ✗ Historiku i shkollave profesionale tregon se si hapja, shkurtimi dhe mbyllja e shkollave si dhe degëve, drejttimeve apo profileve në vite, ka patur oshilacione të mëdha çka tregon se ato nuk janë bërë të studiuara në bazë të nevojave për specialistë sipas drejttimeve që kishte industria e asaj kohe dhe nevojave që ka tregu i punës dhe sipërmarrjet sot të ndara sipas rajoneve dhe prioritetëve të tyre për sot dhe të ardhmen.
- ✗ Është kryer kalimi i fushës së arsimit profesional dhe bashkimi me fushën e formimit profesional nga MSA në MMSR duke krijuar një fushë atë të arsimit dhe formimit profesional, pa ndonjë studim *“si ka qenë - si është - si do të bëhet”* ku të jepen efektet dhe pritshmëritë e tij në krijimin e kësaj qasjeje të re të administrimit të kompetencave, aseteve, burimeve njerëzore dhe financiare;
- ✗ Nuk ka akt ligjor për transferimin e arsimit të mesëm profesional nga varësia e MSA në varësinë e MMSR me të gjitha modalitetet që e shoqërojnë këtë lëvizje, por vetëm VKM për përcaktimin e fushës së MMSR;

- ✘ Në aktin ligjor të përcaktimit të fushës së MMSR “nënkuptohe” bashkimi i arsimit profesional me formimin profesional gjë e cila nuk është sqaruar në këtë VKM apo në ndonjë akt tjetër;
- ✘ Nuk janë përfshirë në këtë “zhvendosje” shkollat publike social-kulturore (artistike, sportive, të gjuhëve të huaja), çka do të thotë se nuk është e përcaktuar saktë kush përfshihet në shkollat profesionale apo cilat janë ato;
- ✘ Nuk është përshtatur i gjithë legjislacioni me kalimin e këtij sistemi në vartësi të MMSR sepse kryesisht i gjithë legjislacioni si ligjet, VKM, urdhra, udhëzime dhe rregullore që kanë rregulluar marrëdhëniet e funksionimit të arsimit profesional i përkasin periudhës kur ky arsim ka qenë brenda gjithë sistemit arsimor në varësi të MASH ndryshuar me MSA;
- ✘ MMSR nuk ka institucione për mbikëqyrjen, monitorimin, zhvillimin e infrastrukturës, etj., të sistemit të arsimit dhe formimit profesional, sepse ato janë në varësi të MSA;
- ✘ Në MMSR, personeli që ndjek sistemin e arsimit dhe formimit profesional është shumë i vogël në numër duke patur parasysh problematikën e tij, si dhe duke e krahasuar me sistemin e arsimit të mesëm që mbikëqyret nga MSA dhe një grup institucioneesh në varësi të saj mund të themi që është në MMSR “nuk ka personel” për mbikëqyrjen e tij;
- ✘ Nuk i janë kaluar plotësisht sistemit të arsimit dhe formimit profesional kompetencat nga pushteti vendor, të cilat kanë ndikuar negativisht në mbarëvajtjen e procesit mësimor, në sigurimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve shkollore, konvikteve dhe laboratorëve në shkollat profesionale në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- ✘ Nuk është mbledhur Këshilli Kombëtar i AFP-së si organ këshillimor trepalësh (shtet-punëmarrës-punëdhënës) si rekomandues i politikave për zhvillimin e sistemit të AFP-së, si dhe nuk dalë akt ligjor për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij;
- ✘ Problematike në të gjithë sistemin e AFP-së është gjendja e stafit të mësuesve që japin lëndët teknike, e cila karakterizohet nga: mosha mesatare e lartë ose afër moshës së pensionit; kualifikimi i ulët; shumë prej tyre kanë një formim të papërshtatshëm arsimor, japin mësim lëndë krejtësisht të ndryshme nga ato për të cilat janë diplomuar, ose edhe mund të mos kenë një diplomë universitare; u mungon kualifikimi/trajnimi paraprak, si edhe ai në punë, etj.;
- ✘ Mospërputhje ndërmjet drejtimeve e profileve arsimore të ofruar dhe kërkesave të tregut të punës;
- ✘ Mungesë të bashkëpunimit efektiv të ofruesve të AFP me bizneset, (shoqëritë dhe kompanitë);
- ✘ Ka mbivendosje të drejtimeve e profileve të shërbimit Arsimor me ato të Formimit profesional;
- ✘ Nuk ka zhdërvjelltësi për të reflektuar në kohë kërkesat dinamike të tregut të punës në nivel lokal e kombëtar;
- ✘ Nuk ka përfunduar procesi rishikimit tërësor dhe hartimi përfundimtar i listës kombëtare të profesioneve dhe i përshkrimeve përkatëse, i cili është një instrument për klasifikimin e strukturës së punësimit në vendin tonë e cila më pas i përcillet për miratim Këshillit të Ministrave;

- ✘ Mungon i gjithë kuadri institucional ligjor për akreditimin e institucioneve që ofrojnë arsimim dhe formim profesional, megjithëse shprehet në ligjin e AFP-së dhe në VKM për krijimin e AKAFPK-së;
- ✘ Deri më sot nuk është bërë asnjë akreditim i institucioneve të AFP-së;
- ✘ Nuk janë përcaktuar kritere dhe standarde për vlerësimin dhe certifikimin e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional;
- ✘ Nuk ka procedura të miratuara për kryerjen e procesit të akreditimit për institucionet e arsimit dhe formimit profesional;
- ✘ AKAFPK nuk ka studim paraprak mbi arsyet e kalimit të sistemit të arsimit profesional nga vartësia e Ministrisë së Arsimit e Sportit në vartësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe perspektivën e tij në vartësi të MMSR;
- ✘ Në ligjin për AFP dhe atë për KSHK nuk janë parashikuar procedura të akreditimit të kurrikulave të arsimit dhe formimit profesional, ku garantimi i cilësisë së zhvillimit të skelet-kurrikulave bazohet në një metodologji të caktuar nga AKAFPK, e cila parashikon zhvillimin paraprak të analizës së profesioneve, zhvillimit të përkrahjeve të kualifikimeve profesionale dhe mbi bazën e tyre hartohen skelet-kurrikulat përkatëse dhe më pas miratohen nga Ministri përgjegjës;
- ✘ Nuk ka procedura dhe metodologji për miratimin e skelet-kurrikulave, si dhe programeve afatshkurtra të formimit profesional;
- ✘ Nga AKAFPK mbetet akoma punë për të bërë në kuadër të përditësimit të ofertës dhe rishikimit të skelet-kurrikulave në shërbim të përshtatjes me të rejtat e fundit të shkencës dhe teknologjisë, e cila duhet të jetë thelbësore në këto planifikime;
- ✘ Me gjithë punën e bërë si nga ana e MMSR, ashtu dhe AKAFPK nuk ka tregues mbi matjen e përshtatshmërisë së kurrikulave të arsimit dhe formimit profesional me tregun e sotëm e të ardhshëm të punës;
- ✘ Nuk ka përputhje të varësisë institucionale dhe proceduarve të funksionimit të tyre të shprehura ndërmjet VKM nr. 321, datë 21.04.2011 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve” dhe ligjit nr. 10247, datë 04.03.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”;
- ✘ Nuk është krijuar e për pasojë nuk ka funksionuar Këshilli i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, i cili duhet të merret me hartimin, miratimin e politikave dhe të rregulloreve të KSHK-së, dhe të politikave që lidhen me institucionet përgjegjëse për zbatimin e funksioneve të KSHK-së dhe bashkërendimi i veprimtarive për zbatimin e tyre.
- ✘ Në sistemin e arsimit dhe formimit profesional nuk janë llogaritur sa kushton realizimi i praktikave mësimore për çdo praktikant sipas drejtimeve mësimore (mekanik, rrobaqepës, kuzhinier, elektrikist, ndërtues, etj., etj.).
- ✘ Nuk ka standarde dhe kritere mbi realizimin financiarisht të profesioneve të ofruara nga sistemi i arsimit dhe formimit profesional;
- ✘ Nuk ka një studim mbi analizën e rentabilitetit dhe të përshtatshmërisë për të gjykuar mbi plotësimin e kënaqësive të palëve të interesit, qeverisë, nxënësve, të rinjve, individëve, dhe sipërmarrjeve e biznesit në fushën e arsimit dhe formimit profesional e cila të bazohet në:

- parimet e vlerës për para;
 - në përputhshmërinë e sistemit e formimit profesional me objektivat strategjike kombëtare dhe objektivat strategjike të tij;
 - rentabilitetin ekonomik të mundshëm;
 - aftësinë e sistemit për të tërhequr financime buxhetore e financime private.
- ✘ Ka mungesa të theksuara në fonde buxhetore për sigurimin e bazës materiale në institucionet e sistemit të arsimit dhe formimit profesional si dhe të fondeve buxhetore për investime;
 - ✘ Nuk ka standarde dhe kritere mbi realizimin dhe funksionimin financiarisht të profesioneve të ofruara nga sistemi i arsimit dhe formimit profesional
 - ✘ Nuk ka sistem gjurmimi për arsimin profesional, duke përfshirë si punësimin e atyre që diplomohen apo certifikohen, ashtu edhe/ose studimet pas-dytësore apo tretësore.
 - ✘ Nuk ka tregues mbi matjen e përshtatshmërisë së arsimit dhe formimit profesional me tregun e sotëm dhe ardhshëm të punës;
 - ✘ Nuk ka tregues mbi hapjen ose ofrimin e drejtimeve dhe kurseve të specializuara në sistemin e arsimit dhe formimit profesional në përputhje me zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë, me kulturën dhe traditën kombëtare, ndryshimeve dhe kërkesave të tregut të punës;
 - ✘ Nuk është matur në zbatim të ligjit dhe strategjisë të AFP, nëse është arritur harmonizimi i arsimit dhe formimit profesional, në përputhje me perspektivën e zhvillimit ekonomik, kombëtar, rajonal dhe kërkesat e tregut të punës;
 - ✘ Nuk ka tregues statistikorë mbi matjen e punësimit të nxënësve sipas profesioneve, të arsimuar nga shkollat e mesme të arsimit profesional publike dhe jo publike;
 - ✘ Nuk ka tregues statistikorë mbi matjen e punësimit të kursantëve sipas profesioneve, të kualifikuar nga qendrat e formimit profesional publike e jo publike;
 - ✘ Nuk ka regjistër kombëtar të nxënësve sipas numrit personal për shkollat e mesme profesionale, si ato publike, ashtu dhe jo publike, por të dhënat e tyre janë në të regjistruara vetëm në regjistrat (amzave) në shkollat profesionale, ku ruhen të dhëna të plota të rezultateve dhe frekuentimit të nxënësve përgjatë gjithë viteve të studimit;
 - ✘ Nuk ka regjistër kombëtar të kursantëve sipas numrit personal për qendrat e formimit profesional publike dhe jo publike;
 - ✘ Nuk ka plan veprimi për arsimin profesional dhe formimin profesional në bashkëpunim me bashkitë për evidentimin e profesioneve sipas nevojave dhe prioriteteve të tyre;

Disa nga konkluzionet e këtij auditimi sipas gjetjeve në mënyrë të përmbledhur janë;

- Mos-njohja, përshtatja dhe analizimi i zhvillimit të veprimitarisë së sistemit të arsimit dhe formimit profesional ndikon negativisht; në cilësinë dhe masivitetin e tij; goditjes së reputacionit të krijuar në vite për shkollat apo qendrat; përcaktimit të nevojat për mësues e specialistë të kualifikuar e të trajnuar mirë që garantojnë cilësinë e mësimdhënies e mësimnxënies; në përcaktimin e nevojave për fonde për përmirësimin e kushteve të shkollave dhe kompletimi me reparte e baza prodhuese; përcaktimin e nevojave për pajisje me kabinete të lëndëve teknike; përfundimit të investimeve të kryera në vite;

krijimin e vështirësive në plotësimin me kurrikula sa më cilësore dhe në zhvillim për të reflektuar në kohë kërkesat dinamike të tregut të punës; krijimit të diskordancës ndërmjet ofertës arsimore të ofruar dhe kërkesave të tregut të punës; krijimit të mosbesimit dhe shkëputjes së bashkëpunimit efektiv të ofruesve të AFP, me bizneset, shoqëritë dhe kompanitë; krijimit të padëshiruar të mbivendosjes së ofertave të shërbimit Arsimor me ato të Formimit profesional; etj.

- Përshtatja, përmirësimet ligjore dhe plotësimi i strategjisë për sistemin e arsimit dhe formimit profesional bëjnë që ky sistem të ecë me ritmin e kohës, kushtimit të vëmendjes ndaj problematikave që e kanë shoqëruar në këto vitet e fundit, duke e reformuar nëpërmjet adresim të plotë të fenomeneve që rregullojnë organizimin, funksionimin, institucionalizimin, rritjen e cilësisë, rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe efektivitetit të tij, në funksion të transformimit të Arsimit e Formimit Profesional në një sistem me shumë mundësi edukimi dhe punësimi.
- Kryerja e këtyre përmirësimeve është e rëndësishme, duke patur parasysh atë që shkollat profesionale janë gjithashtu njësi e rëndësishme, sepse fillimisht ato ofrojnë edukim të përgjithshëm intelektual e qytetar dhe në vijim edhe atë profesional, nxit punëdhënësit që të alokojnë më shumë burime për zhvillimin e forcës së punës, si dhe për të siguruar monitorimin e tij që t'iu përgjigjet gjithmonë e më mirë nevojave të individëve, punëdhënësve dhe ofruesve.
- Përshtatja, përmirësimet ligjore dhe plotësimi i strategjisë për sistemin e arsimit dhe formimit profesional do të konsistojnë gjithashtu në garantimin e cilësisë së kualifikimeve profesionale, në përputhje me kërkesat e tregut vendës të punës dhe më gjerë, në përputhje me (ISCED), me (KSHK) dhe me (KEK) si dhe për garantuar gjithnjë parametra cilësore në edukimin e të rinjve, si qytetarë të denjë të vendit.
- Më gjithë punën e bërë për riorganizimin e sistemit të AFP për t'iu përshtatur ndryshimeve shoqërore, ai duhet të jetë; një proces dinamik dhe i vazhdueshëm, me objektiva të përcaktuara, për të përshtatur sa më tepër të jetë e mundur ofertën e AFP me kërkesat e ndryshimeve shoqërore dhe lëvizjet e popullsisë; ndryshimet e përshtatja e sistemit të AFP, do të jetë një proces dinamik dhe i vazhdueshëm sepse teknologjia dhe ekonomia janë gjithnjë në evoluim; oferta e ofruesve të jetë sa më cilësore dhe mundësisht t'i paraprijë kërkesave të teknologjisë nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të përmbajtjes kurrikulare dhe programeve, kualifikimit të burimet njerëzore, kompletimit me infrastrukturë më moderne, etj.,
- Pa një sistem mendje-hapur menaxhimi të sistemit të shkollave dhe qendrave të arsimit dhe formimit profesional do të jetë i pamundur trajtimi dhe zgjidhja e shumë problemeve, të cilat kanë ngadalësuar përparimin si në drejtimin sasior, ashtu dhe cilësor të sistemit të AFP-së në Shqipëri.
- Akreditimi, certifikimi, krijimi i standardeve përmirësimi i kurrikulave dhe krijimi e miratimi i procedurave për realizimin e tyre, duhet të jetë në qendër të vëmendjes për të gjithë institucionet e sistemit të arsimit dhe formimit profesional dhe specialistëve arsimorë e mësimdhënësit, për të bërë të mundur përshtatjen me kërkesat e tregut; pasqyrimin të zhvillimeve teknologjike e kërkesave të reja për profesione që janë tashmë shumë dinamike; vlerësimin të partneritetit publik-privat si një element kyç i zhvillimit cilësor të ofruesve të AFP në rritjen e kualifikimit dhe kryerjen e praktikave profesionale

të nxënësve; planifikimit afatgjatë për rritjen e investimeve për infrastrukturë moderne, laboratorë dhe kabinete që do t'i paraprijnë nivelit dhe zhvillimit teknik dhe teknologjik; etj.;

- Krijimi i standardeve dhe hartimi i procedurave për akreditim të institucioneve dhe miratim të kurrikulave duhet të jenë në qendër të vëmendjes dhe objekt ndryshimesh e përmirësimesh të vazhdueshme, si për strukturat drejtuese ashtu dhe për sipërmarrësit e palët e interesuara për këtë sistem sepse do të sjellë përditësimin e tyre dhe vlerësimin e kualifikimeve të stafit mësimor në përputhje me specifikat profesionale që kërkojnë kurset dhe drejtimit mësimorë që ofrohen nga AFP; përfshirjes së përvojës evropiane e bashkëkohore; etj.; me qëllim krijimin e kushteve për zhvillimin e sistemit modern dhe unik të orientuar në mënyrë të vazhdueshme ndaj zhvillimeve dhe standardeve të reja të BE-së, etj.
- Zhvillimi normal i praktikave sipas drejtimit mësimor realizohet cilësisht sipas objektivave vetëm duke përcaktuar drejtë dhe saktë sipas llojit, sasisë dhe vlerën e “lëndëve të para” ose më saktë koston që duhet për çdo lloj produkti që do të prodhohet apo shërbim që do të mësohet në këtë praktikë, gjithashtu është e domosdoshme dhe për programim sa më të saktë të fondeve buxhetore që duhen për çdo drejtim e në tërësi.
- Gjithashtu, përcaktimi i kostove për çdo produkt apo shërbim që do të mësohet në praktikën mësimore sipas drejtimeve të sistemit të AFP është e domosdoshme për çdo drejtues të suksesshëm dhe bazë e mirë për të garantuar një ecuri cilësore, të qëndrueshme, afatgjatë të mësimdhënies dhe mësimnxënies gjatë realizimit të praktikave shumë të nevojshme për kualifikimin e nxënësve dhe të rinjve me dijet e zanatit.
- Mungesa e fondeve çon në zhvillimin me mangësi të procesit mësimor dhe aq më tepër në realizimin e praktikave mësimore aq të nevojshme për një mësimnxënie cilësore në sistemin e AFP.
- Mospasja e treguesve të mësipërm është me pasoja në analizimin kërkesave të tregut të punës, në përputhje me zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë, kulturën dhe traditën kombëtare dhe me perspektivën e zhvillimit ekonomik, kombëtar e rajonal;
- Moskrijimi i sistemit të gjurmimit të diplomuarve dhe certifikuarave nga institucionet e arsimit dhe formimit profesional sjell mungesën dhe pasjen e një informacioni të pamjaftueshëm mbi shkallën e punësueshmërisë së nxënësve dhe individëve; nuk vlerësohet se sa i arrirë është niveli dhe përshtatshmëria e njohurive të marra në shkollë apo qendrat e formimit profesional krahasuar me kërkesat e vendit të punës, kohës, përshtatjes me teknologjinë e re etj.; nuk identifikohen drejtimit mësimorë apo kurset reja me perspektivë të mirë punësimi;
- Mosmatja e treguesve dhe objektivave të strategjisë sjell mosnjohjen me realitetin; sa mirë është hartuar strategjia; a ishte me efektivitet shkëputja e arsimit profesional nga sistemi arsimor; etj.;
- Hartimi i regjistrave kombëtare do të bënte të mundur evidentimin në tërësi të personave që kanë mbaruar në sistemin e arsimit dhe formimit profesional, lëvizjet demografike të tyre, punësimin e tyre, përsëritjen e kurseve, mund të shmangte abuzimet me përfitimin e diplomave pa i mbaruar studimet apo kurset, etj.
- Hartimi i planeve të veprimit në bashkëpunim me bashkitë për evidentimin e profesioneve sipas nevojave dhe prioriteteve të rajonit do të rriste shkallën e punësimin

dhe uljen e papunësisë, si dhe do të promovonte vlerat më të mira dhe traditën e secilit rajon.

Nisur nga gjetjet dhe konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtij shërbimi:

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin e Auditimit me temë “Shkollimi Profesional në Shqipëri”, të ushtruar në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit dhe Formimit Profesional, Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Qendrat e Formimit Profesional dhe Shkollat e Mesme publike të arsimit profesional të shpërndara në 12 qarqet; Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

Rekomandim: 1

- ✓ MMSR, institucionet e arsimit dhe formimit profesional, pushteti vendor, grupet e interesit etj., të studiojnë dhe bashkëpunojnë në krijimin e një klime sa më të favorshme e afatgjatë sipas nevojave të tregut të punës, të jetëgjatësisë së institucioneve të sistemit të arsimit dhe formimit profesional dhe drejtimeve që ato ofrojnë, në përputhje me kushtet realitetin, nevojat e rajonit ku ato veprojnë, përvojave me të mira si dhe standardet e BE.

Në vazhdimësi

Rekomandim: 2

- ✓ MMSR në bashkëpunim me MAS dhe qeverinë të marrin masa për përmirësimin e gjithë paketës ligjore në përputhje me kushtet dhe realitetin të kësaj qasjeje të re të administrimit, kompetencave, aseteve, burimeve njerëzore dhe financiare të sistemit të arsimit dhe formimit profesional.
- ✓ MMSR në bashkëpunim me MAS, për qasjen e të re të arsimit dhe formimit profesional, të hartojnë strategji të re për këtë sistem, për një mësimnxënie dhe mësimdhënie në funksion të tregut të punës, të zhvillimeve teknologjike, nevojave rajonale për zanatçinj apo profesionistë të mesëm të mirë-kualifikuar.
- ✓ MMSR në bashkëpunim me MAS të përcaktojë saktë përkufizimin cila quhet “shkollë profesionale” dhe hartimin e plotë të listës së shkollave profesionale.
- ✓ MMSR në bashkëpunim me qeverinë të marrë masa për krijimin e institucioneve të hartimit të politikave, mbikëqyrjes, monitorimit, burimeve njerëzore, zhvillimit të infrastrukturës, hartimit të procedurave përkatëse për mirëfunksionimin normal të sistemit, plotësimin me personel, etj., të sistemit të arsimit dhe formimit profesional nga niveli qendror e deri në bazë. (MMSR + institucione të sistemit të AFP)
- ✓ MMSR të mbledhë Këshillin Kombëtar të AFP-së dhe në bashkëpunim me qeverinë të nxjerrë aktin ligjor për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij.

- ✓ MMSR në bashkëpunim me qeverinë të marrë masa për zgjidhjen e problematikave shqetësuese që ekzistojnë për stafin e mësuesve të cilët japin lëndët teknike, si dhe trajnimin e tyre me zhvillimet e reja të teknologjisë e të kohës.
- ✓ MMSR në bashkëpunim me qeverinë dhe organet e pushtetit vendor të marrin masa për t'ia kaluar plotësisht sistemit të arsimit dhe formimit profesional kompetencat nga pushteti vendor të miratuara me ligj.

Menjëherë

Rekomandim: 3

- ✓ MMSR në bashkëpunim me AKAFPK të përfundojë dhe të dërgojë për miratim Këshillit të Ministrave listën kombëtare të profesioneve dhe përshkrimeve përkatëse si instrument për klasifikimin e strukturës së punësimit në vendin tonë;
- ✓ MMSR në bashkëpunim AKAFPK dhe institucionet e arsimit dhe formimit profesional, referuar dhe përvojave më të mira evropiane, të plotësojë, përputhë dhe hartojë ligje vendime e urdhëresa për akreditimin e institucioneve që ofrojnë arsimim dhe formim profesional;
- ✓ MMSR në bashkëpunim AKAFPK dhe institucionet e arsimit dhe formimit profesional, referuar dhe përvojave më të mira evropiane të hartojë, përcaktojë kriteret dhe standarde për vlerësimin dhe certifikimin e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, të përcaktojë procedura të miratuara për kryerjen e procesit të akreditimit për institucionet e arsimit dhe formimit profesional, si dhe të kryejë akreditimin e tyre;
- ✓ MMSR në bashkëpunim AKAFPK dhe institucionet e arsimit dhe formimit profesional, referuar dhe përvojave më të mira evropiane të hartojë e përcaktojë procedura dhe metodologji për miratimin e skelet-kurrikulave, si dhe programeve afatshkurtra të formimit profesional;
- ✓ MMSR në bashkëpunim AKAFPK dhe institucionet e arsimit dhe formimit profesional, referuar dhe përvojave më të mira evropiane, të hartojë e përcaktojë tregues mbi matjen e përshtatshmërisë së kurrikulave të arsimit dhe formimit profesional me tregun e sotëm e të ardhshëm të punës;
- ✓ MMSR në bashkëpunim me qeverinë të marrë masa për miratimin e VKM përkatëse për funksionimin e Këshillit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Brenda vitit 2017

Rekomandim: 4

- ✓ MMSR në bashkëpunim me institucionet e sistemit të AFP, grupet e interesit dhe përvojat më të mira të marrë masa për llogaritjen e kostove për çdo produkt ose shërbim të realizuar në praktikën mësimore që zhvillohen në laboratorët e institucioneve të AFP sipas drejtimeve të prioritetive mësimore;
- ✓ MMSR në bashkëpunim me institucionet e sistemit të AFP, grupet e interesit dhe përvojat më të mira, të hartojë standardet dhe kriteret mbi realizimin financiarisht të profesioneve të ofruara nga sistemi i arsimit dhe formimit profesional;
- ✓ MMSR në bashkëpunim me institucionet e sistemit të AFP, grupet e interesit dhe përvojat më të mira, të kryejnë studime mbi analizën e rentabilitetit dhe të

përshtatshmërisë të investimeve të kryera në laboratorë, pajisje, mjete mësimore për realizimin e praktikave, sepse ato kanë përfitime afatgjata në zhvillimin e procesit mësimor dhe përgatitjen cilësore të profesionistëve të ardhshëm.

Brenda vitit 2017

Rekomandim: 5

- ✓ MMSR në bashkëpunim me institucione e sistemit të AFP, biznesin dhe grupet e interesit të krijojë sistem gjurmimi për arsimin profesional;
- ✓ MMSR në bashkëpunim me institucione e sistemit të AFP të hartojë tregues mbi matjen e përshtatshmërisë së tij; mbi hapjen ose ofrimin e drejtimeve dhe kurseve të specializuar në përputhje me zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë, me kulturën dhe traditën kombëtare, ndryshimeve dhe kërkesave të tregut të punës;
- ✓ MMSR në bashkëpunim me institucione e sistemit të AFP të masë arritjen e objektivave të arsimit dhe formimit profesional, në përputhje me perspektivën e zhvillimit ekonomik, kombëtar, rajonal dhe kërkesat e tregut të punës;
- ✓ MMSR në bashkëpunim me institucione e sistemit të AFP të marrë masa për krijimin e regjistrave kombëtarë të nxënësve, të rinjve apo individëve që regjistrohen, largohen, dhe certifikohen nga ky sistem;
- ✓ MMSR në bashkëpunim me institucione e sistemit të AFP dhe bashkitë të hartojë planveprimi për evidentimin e profesioneve sipas nevojave dhe prioriteteve të tyre.

Brenda vitit 2017

Në përputhje me nenin 30 të Ligjit 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R